

Kontrolli i Lartë i Shtetit zhvillon workshop-e në kuadër të Planifikimit të Veprimtarisë Audituese për vitin 2023.

Në kuadër të hartimit të planit të veprimtarisë audituese për vitin 2023, Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke nisur nga data 2 nëntor, po zhvillon workshop-e me të gjithë audituesit nga departamentet e auditimit të KLSH-së.


Këto workshop-e kanë për qëllim gjenerimin e ideve dhe propozimeve nga të gjithë audituesit për planifikimin e programit të auditimit për vitin 2023, mbi rritjen e numrit të auditimeve financiare dhe qasjen e auditimeve të performancës drejt fushave me ndjeshmëri publike, duke pasur në konsideratë zbatimin e Objektivave Strategjike të KLSH-së, rekomandimet e adresuara nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, si dhe nga Organizmat Ndërkombëtare.

Në workshop-in e zhvilluar në datën 04 nëntor 2022 nga Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit dhe Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore, ka qenë i pranishëm edhe kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu.

Datë 02 nëntor 2022 zhvillohet workshop-i nga Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore:



Datë 03 nëntor 2022 zhvillohet workshop-i nga Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja dhe Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit:



Datë 04 nëntor 2022 zhvillohet workshop-i nga Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit dhe Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore, i pranishëm edhe Kryetari i KLSH, z.Arben Shehu:



Datë 07 nëntor 2022 zhvillohet workshop-i nga Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit:



Datë 10 nëntor 2022 zhvillohet workshop-i nga Departamenti i Auditimit të Performancës:

